

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-1738-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **NDERTIMI I FUSHAVE SPORTIVE KOMORAN ,KORRETICË E EPËRME DHE ARLLAT** Projekt dyvjeçar

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Treing SH.P.K.
NUI	812136522
Adresa	Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049 293 969
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uljan Thaçi
Adresa elektronike	3ingshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	29.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

NDERTIMI I FUSHAVE SPORTIVE KOMORAN ,KORRETICË E EPËRME DHE ARLLAT Projekt dyvjeqar

- Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate në datën 30.03.2026.
 - Hapja e tenderëve është paraparë për tu bërë me datë 20.04.2026 por tash pas Kërkesës për Rishqyrtim është shtyrë deri më 27.04.2026.
 - Të pakënaqur me disa nga kriteret dhe kërkesat të dosjes së tenderit me datë 14.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.
 - AK me date 15.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim me datë 25.04.2026 OSHP-se me ankesë.
 - OSHP me datë 19.05.2026 ka nxjerrë Vendimin me nr. 2026/0268 ku i ka aprovuar të gjitha pretendimet tona ndërsa AK-së i ka rekomanduar që të bëjë përmirësimin dhe ndryshimin e dosjes së tenderit.
 - AK me datë 21.05.2026 ka publikuar dosjen e tenderit me ndryshime ku përveç disa ndryshimeve të parëndësishme që nuk lidhen me pretendimet tona nuk ka bërë asnjë ndryshim tjetër.
 - Hapja publike ishe paraparë të bëhet me datë 01.06.2026, mirëpo të pakënaqur me mos ndryshimin e dosjes së tenderit ashtu siç ka rekomanduar OSHP, ne prap me datë 26.05.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
 - AK me datë 29.05.2026 e ka refuzuar kërkesën tonë për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem i OSHP-së me këtë ankesë.
- Kriteri i vlerësimit ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.
- OSHP me datë 10.07.2026 ka nxjerrë Vendimin me nr. 2026/0368 ku i ka aprovuar të gjitha pretendimet tona ndërsa AK-së i ka rekomanduar që të bëjë përmirësimin dhe ndryshimin e dosjes së tenderit.
 - Hapja e tenderëve është paraparë për tu bërë me datë 24.07.2026.
 - Njoftimi për dhenie të kontratës 12.08.2026.
 - Vendimi i AK: 21.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Referoju dokumenteve te bashkangjitur

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik:

Neni 1 Qellimi

- **Neni 7.1 dhe 7.2**, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe transparencë;
- **Neni 51.1, 51.2 dhe 51.3**, obligimi që kriteret dhe dokumentet dëshmuuese të përcaktohen paraprakisht dhe në mënyrë të plotë në DT;
- **Neni 56.1 dhe 56.3**, vlerësimi vetëm sipas kërkesave të përcaktuara paraprakisht dhe ndalimi i eliminimit mbi bazën e kërkesave që nuk janë paraparë në DT;
- **Neni 59.2 dhe 59.4**, sqarimi dhe vlerësimi i përgjegjshmërisë së tenderëve;
- **Neni 60.1.1**, sipas të cilit kontrata i jepet tenderit **të përgjegjshëm** me çmimin më të ulët;
- **Neni 69.1**, dëshmitë për aftësinë teknike dhe profesionale;
- **Neni 72**, plotësimi dhe qartësimi i dokumentacionit.

Neni 51 kërkon që AK t'i përcaktojë paraprakisht në DT kriteret dhe dokumentet që duhet të dorëzohen, ndërsa neni 56.3 ndalon diskualifikimin mbi bazën e një kërkesë që nuk është paraparë në Njoftimin për Kontratë dhe DT.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik:

- **Neni 38.2, 38.3, 38.4 dhe 38.5**, sqarimi i dokumenteve dhe obligimi për trajtim të njëjtë të OE-ve;
- **Neni 40.1 dhe 40.2**, vlerësimi vetëm sipas kriterëve të DT-së dhe ndalimi i shtimit,

ndryshimit ose heqjes së kërkesave gjatë evaluimit;

- **Neni 39.13**, nëse gjatë verifikimit konstatohet konflikt interesi i ndonjë personi të përfshirë në Komisionin Vlerësues.

Në veçanti, neni 38.4 kërkon që mundësia për informacion shtesë të sigurohet **“në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik”**, ndërsa neni 40.2 ndalon ndryshimin ose shtimin e kriterëve gjatë vlerësimit.

Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit:

- **Neni 6**, konflikt real, potencial apo në dukje;
- **Neni 7**, identifikimi dhe raportimi i dyshimit të arsyeshëm;
- **Neni 8**, obligimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1

Për pozitën e Menaxherit të Projektit, DT ka kërkuar Inxhinier të Diplomuar apo Master të Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me minimum gjashtë vite përvojë pune pas diplomimit.

Mirëpo, si **dëshmi**, DT ka përcaktuar vetëm:

“Menaxheri i projektit duhet të këtë Kontratën e punës ose parakontratë për angazhim për këtë projekt.”

Për këtë pozitë nuk është kërkuar shprehimisht CV, referencë profesionale apo ndonjë dokument tjetër i veçantë.

ekonomike dhe financiare		1.Qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 300.000,00 Euro	1.Deklaratat tatimore vjetore Administratën Tatimore të Ko
	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata te natyres se ngjajshme ne tri vitet e shkuara nga data e pubikimit te njoftimit per kontrate. ne vlerë prej jo më pak se 350,000.00 euro.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Deshmia 1.Lista e kontratave e këti aktivitetit të prokurimit të vitet e shkuara nga data e publik për kontrate duhet të dorzo origjinale të jete e nënshkruar OE. Duke specifikuar emrin e kontrates,daten e fillimit dhe kontrates dhe referenca apo raport teknik. Referencat apo raport teknik duhet të korrespondoj kontratave.
		.Operatori Ekonomik duhet të posedoj një strukturë stabile dhe te qëndrueshme organizative me qëllim të sigurimit të stafit të mjaftueshme për realizimin e projektit	DËSHMI Lista e Stafit duhet të dhe e vulosur.
		3.Kërkesa Për Menaxherin e Projektit duhet te jetë Inxhinier i diplomuar b apo master i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, duhet të ketë minimumi 6 vite pervoje pune pas diplomimit	DËSHMI Menaxheri i projek Kontratën e punës ose pa angazhim për këtë projekt. prezantohet parakontratë për a projekt duhet të specifikohet ti aktivitetit të prokurimit.
		4. Një (1) Inxhinier i diplomuar apo master të Menaxhimit te Emergjencave te jete I lincsuar si Ekspert I SSHP, 4.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar apo master të Makinerisë, së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit,	DËSHMI Për Piken 4 dhe 4.1 S Kontratë të punës valide ose pa angazhim për këtë projekt. prezantohen parakontratë për këtë projekt duhet të specifil numri i aktivitetit të prokurimi të dorëzohen edhe diploma kërkuara, CV e nënshkruar nga dhëna të sakta, si dhe refere mëparshme profesionale
		5.Një (1) teknik Arkitekturës të jetë i certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore. 5.1 Një (1) teknik Ndërtimtarisë	DËSHMI Të silltet diploma e s kopja e certifikatës apo licencës shtetërore. kontratë të punë parakontratë për këtë project.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Pretendimi 2

DT ka kërkuar:

“Një (1) Teknik Arkitekturës të jetë i certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore.”

DT nuk ka përcaktuar nivel, kategori apo emërtim të posaçëm të licencës.

Z. Hamdi Qorri posedon diplomë si Teknik i Arkitekturës dhe **Licencë A si Arkitekt i Licencuar, nr. A-0830**, pra licencim profesional të nivelit më të avancuar në të njëjtën fushë.

Licenca është lëshuar nga **Oda e Arkitektëve të Republikës së Kosovës**. Sipas Ligjit Nr. 08/L-012, Oda ushtron **autoritet publik**, ndërsa një nga kompetencat e saj themelore ligjore është pikërisht **licencimi i arkitektëve në fushën e ndërtimit**.

Prandaj, AK nuk ka bazë që z. Qorri ta refuzojë vetëm sepse licenca mban emërtimin **“Arkitekt i Licencuar”** dhe jo **“Teknik i Arkitekturës”**, pasi DT nuk ka kërkuar një nivel apo emërtim të tillë specifik.

Ndërsa te z. **Endrit Berisha**, edhe nëse diploma e tij pranohet për pjesën arsimore, licenca e paraqitur është e kategorisë **A2-3 në fushën e Trashëgimisë Kulturore**, për konservim/restaurim dhe e identifikon si **teknik të ndërtimtarisë**, jo si Teknik të Arkitekturës apo Arkitekt të Licencuar.

Pra, problemi te z. Berisha **nuk është niveli i licencës**, por relevanca e saj ndaj pozitës së kërkuar.

Nëse AK refuzon Licencën A të z. Hamdi Qorri, e cila lidhet drejtpërdrejt me arkitekturën dhe është lëshuar nga autoriteti publik kompetent për licencimin e arkitektëve, nuk ka bazë të pranojë një licencë që lidhet me konservim/restaurim në trashëgimi kulturore dhe e përcakton kandidatin si teknik të ndërtimtarisë.

Kjo përbën vlerësim jo konsistent dhe trajtim të pabarabartë në kundërshtim me **nenin 7 të LPP-së**.

Kërkojmë që OSHP të konstatojë se z. Hamdi Qorri e plotëson kërkesën e DT-së, ndërsa dokumentacioni i z. Endrit Berisha nuk dëshmon licencimin relevant të kërkuar.

Pretendimi 3

Në Kërkesën për Rishqyrtim kemi ngritur rrethana konkrete lidhur me z. **Kushtrim Berisha**, të cilat AK i ka refuzuar pa një verifikim të mjaftueshëm.

Sipas informatave që disponojmë, z. Kushtrim Berisha, pronar i **IDEAL PARTNERS SH.P.K.**, ka qenë i angazhuar si ekspert i jashtëm në Drejtorinë e Infrastrukturës të Komunës së Glllogocit.

Në të njëjtën kohë, dokumentacioni i operatorit të rekomanduar tregon se:

- z. **Jeton Kryeziu**, i angazhuar nga ProBuild në këtë tender, deklaron se punon si ekspert i jashtëm për IDEAL PARTNERS nga 01.01.2023;
- noterizimi i licencës dhe diplomës së z. **Endrit Berisha**, po ashtu i angazhuar nga ProBuild, është bërë me kërkesë të z. Kushtrim Berisha.

Pra ekzistojnë lidhje konkrete:

Kushtrim Berisha › IDEAL PARTNERS › Jeton Kryeziu › ProBuild

dhe

Kushtrim Berisha › dokumentacioni i Endrit Berishës › ProBuild.

AK është përgjigjur se nuk është dëshmuar përfshirja konkrete e z. Kushtrim Berisha në këtë procedurë. Por pikërisht kjo është çështja që kërkon **verifikim institucional**.

Neni 6 i Ligjit Nr. 06/L-011 nuk kërkon vetëm konflikt të provuar. Konflikti ekziston kur interesi privat **ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon** në kryerjen e paanshme të detyrës zyrtare. Ndërsa neni 7 njeh shprehimisht **dyshimin e arsyeshëm** si bazë për raportim dhe verifikim.

Prandaj kërkojmë nga OSHP që të verifikojë:

- periudhën dhe bazën e angazhimit të z. Kushtrim Berisha në Komunë;
- termat e referencës dhe detyrat e tij;
- nëse ka marrë pjesë në projektim, paramasë, specifikime, kritere, sqarime, këshillim apo evaluim;
- nëse ka pasur qasje në dokumentacionin e këtij aktiviteti;
- nëse është deklaruar dhe trajtuar ndonjë konflikt potencial apo në dukje i interesit.

Nuk paragjykojmë ekzistencën e konfliktit apo përgjegjësi penale. Kërkojmë verifikimin e fakteve, pasi lidhjet konkrete të dokumentuara krijojnë dyshim të arsyeshëm që nuk mund të refuzohet vetëm me konstatimin se ndikimi nuk është provuar.

Pretendimi 4

Në Vendimin e datës 21.08.2026, AK ka arsyetuar se oferta jonë është rreth **22,000 € më e lartë** se oferta e operatorit të rekomanduar dhe se eventuale sqarime nuk do ta ndryshonin rezultatin përfundimtar.

Ky arsyetim është i gabuar.

Sipas nenit 56 të LPP-së, së pari bëhet vlerësimi i kualifikimit dhe përgjegjshmërisë së tenderëve, dhe vetëm pastaj zbatohet kriteri për dhënien e kontratës.

Neni 60.1.1 nuk përcakton se kontrata i jepet thjesht ofertës më të lirë, por:

tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Pra, një ofertë më e lirë nuk mund të rekomandohet nëse nuk i përmbush kërkesat e DT-së, ndërsa çmimi më i lartë i ofertës sonë nuk e lejon AK-në të zbatojë ndaj nesh kritere apo standarde më të rrepta.

Së pari duhet të përcaktohet cilat oferta janë të përgjegjshme; vetëm pastaj ka rëndësi diferenca në çmim.

PRETENDIMI 5

Mospërputhje e dukshme e nënshkrimeve të z. Jeton Kryeziu

DT ka kërkuar që CV-ja e z. **Jeton Kryeziu** të jetë e nënshkruar nga vetë punonjësi.

Në CV dhe në Kontratën në Vepër me ProBuild figurojnë **dy nënshkrime dukshëm të ndryshme**, ndonëse të dy dokumentet paraqiten si të nënshkruara nga z. Jeton Kryeziu.

Kjo krijon dyshim serioz se **së paku njëri prej nënshkrimeve nuk është vendosur nga i njëjti person**, ndërsa AK nuk rezulton të ketë bërë asnjë verifikim të kësaj mospërputhjeje.

Në të njëjtën kohë, oferta jonë është eliminuar për mungesë të dëshmive që nuk ishin përcaktuar si obligative në DT, ndërsa dokumentacioni i operatorit të rekomanduar është pranuar pa verifikimin e kësaj paqartësie të dukshme.

Kjo dëshmon **standard të pabarabartë të kontrollit** dhe cenon nenin 7 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP që të sigurojë dhe verifikojë dokumentet origjinale, të kërkojë konfirmim nga z. Jeton Kryeziu për autorësinë e të dy nënshkrimeve dhe, nëse është e nevojshme, të urdhërojë ekspertizë profesionale të nënshkrimeve. Nëse konstatohet se njëri prej dokumenteve nuk është nënshkruar nga z. Jeton Kryeziu, të vlerësohet oferta e operatorit të rekomanduar si e papërgjegjshme në raport me kërkesën e DT-së.

Nga faktet e mësipërme rezulton se oferta jonë është eliminuar duke aplikuar kërkesa dhe interpretim më restriktiv, ndërsa ndaj operatorit të rekomanduar janë pranuar dokumente që nuk dëshmojnë në të njëjtën mënyrë kërkesat e DT-së.

Në veçanti:

- për z. Skender Loshi janë kërkuar dokumente që DT nuk i ka përcaktuar;
- z. Hamdi Qorri posedon diplomën relevante dhe Licencë A në vetë fushën e Arkitekturës, ndërsa është refuzuar;
- për z. Endrit Berisha është pranuar licencë në një fushë tjetër specifike, Trashëgimi Kulturore;
- në dokumentacionin e z. Jeton Kryeziu figurojnë dy nënshkrime dukshëm të ndryshme në CV dhe në Kontratën në Vepër, pa rezultuar se AK ka verifikuar autorësinë e tyre, ndonëse DT ka kërkuar shprehimisht që CV-ja të jetë e nënshkruar nga vetë punonjësi;
- dyshimi i arsyeshëm për konflikt potencial interesi nuk është verifikuar në mënyrë të plotë;
- ndërsa çmimi më i ulët i operatorit të rekomanduar është përdorur si arsyetim për të mos trajtuar në mënyrë të barabartë çështjet e përgjegjshmërisë.

Këto rrethana, të marra së bashku, tregojnë se operatori i rekomanduar nuk i është nënshtruar të njëjtit standard të verifikimit dhe rigorozitetit sikurse ankuesi, duke cenuar trajtimin e barabartë, transparencën dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit sipas nenit 7 të LPP-së

Duke u bazuar në faktet dhe dispozitat e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që:

1. **TË APROVOJË** si të bazuar ankesën e GOE TREING SH.P.K. & N.N.P. ATC COM SH.P.K.;
2. **TË ANULOJË Vendimin e AK-së të datës 21.08.2026**, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim;
3. **TË ANULOJË Njoftimin mbi Vendimin e AK-së B58 të datës 12.08.2026 dhe rekomandimin për dhënie të kontratës për GOE ProBuild Group SH.P.K. & NPN EUROING SH.P.K.;**
4. **TË KTHEJË aktivitetin e prokurimit në rivlerësim;**

5. **TË OBLIGOJË AK-në që z. Skender Loshi të vlerësohet vetëm sipas kërkesave dhe dëshmive të përcaktuara në DT**, pa shtuar dokumente të tjera që nuk janë kërkuar paraprakisht;
6. **TË KONSTATOJË se dokumentacioni i z. Hamdi Qorri e plotëson kërkesën e DT-së**, ndërsa të rivlerësohet dokumentacioni i z. Endrit Berisha dhe relevanca e licencës së tij për pozitën e kërkuar;
7. **TË VERIFIKOJË dokumentacionin e z. Jeton Kryeziu**, për shkak të mospërputhjes së dukshme ndërmjet nënshkrimit në CV dhe nënshkrimit në Kontratën në Vepër, duke kërkuar dokumentet origjinale, konfirmimin e autorësisë së nënshkrimeve dhe, sipas nevojës, ekspertizë profesionale; nëse konstatohet se dokumenti i kërkuar nga DT nuk është nënshkruar nga vetë z. Jeton Kryeziu, të vlerësohen pasojat për përgjegjshmërinë e ofertës së operatorit të rekomanduar. DT ka kërkuar shprehimisht CV të nënshkruar nga vetë punonjësi.
8. **TË VERIFIKOJË konfliktin potencial apo në dukje të interesit lidhur me z. Kushtrim Berisha**, përfshirë natyrën dhe periudhën e angazhimit të tij në Komunë, qasjen në dokumentacion dhe çdo përfshirje eventuale në aktivitetin konkret; kjo çështje është ngritur që në Kërkesën për Rishqyrtim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i kundërligjshëm për eliminimin e ofertës sonë na ka privuar nga mundësia që oferta jonë të vlerësohet në mënyrë të barabartë dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Si pasojë, GOE TREING SH.P.K. & N.N.P. ATC COM SH.P.K. është ekspozuar ndaj humbjes së mundësisë për fitimin dhe realizimin e kontratës, humbjes së fitimit të pritshëm, si dhe shpenzimeve të bëra për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit dhe në procedurat e mjeteve juridike.

Dëmi material rrjedh drejtpërdrejt nga eliminimi i ofertës sonë mbi bazën e kërkesave që nuk ishin përcaktuar si dëshmi në DT dhe nga aplikimi i një standardi të ndryshëm gjatë vlerësimit të operatorit të rekomanduar.

Për këtë arsye rezervojmë të drejtën që, në pajtim me legjislacionin në fuqi, të kërkojmë kompensimin e dëmit material të shkaktuar si rezultat i veprimeve dhe vendimeve të kundërligjshme në këtë procedurë.

Kjo përputhet edhe me atë që keni deklaruar në Kërkesën për Rishqyrtim, ku dëmi është lidhur me humbjen e fitimit të pritshëm dhe shpenzimet e përgatitjes së ofertës

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.